Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**11.01.2024**	**22.01.2024**	**2024/0031**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.01.2024, OE "Marisa SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0031, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Marisa SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapsirave publike" me nr. të prokurimit: "632-23-13225-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0031 i dt:09.01.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së Nr. 04/L-042

AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së Nr. 04/L-042

AK ka shkelur nenin Neni 28 Specifikimet teknike

AK ka shkelur nenin Neni 37 Mostrat e Tenderit Rregullorja Nr.001/2022 Per Prokurim Publik

AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042

AK ka shkelur nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës të LPP-së Nr. 04/L-042
AK ka shkelur nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së Nr. 04/L-042

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakoves ka publikuar tenderin me titull: **"Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapsirave publike"** ku gjat analizes se bere nga ne kemi pare qe ky tendere eshte favorizues ku kushtet dhe kriteret per aplikim jane diskriminuese se dihet shum qarte se vendi yne nuk eshte prodhues i shumicese se ketyre produkteve por keto produkte duhet te transportohen nga Vendet e ndryshem siq eshte Bullgaria e cila ka nje kompani qe ben prodhimin e shumcises se ketyre prdukteve, Autoriteti Konktraktues me keto kritere ka diskriminuar Konukrencen edhe ja pergatit tenderin nje kompanie te cakturar.

Pika 1 Ne Pretendojm qe Sipas pjesemarrjes se tenderit shihet shum qart se te gjitha kushtet dhe kriteret per kontrat si dhe paramasa eshte e pergatitur per kompanin SIQ SHIHET EDHE NE PROCESIN E HAPJES SE KETIJ TENDERI QE TANI ME ESHTE RI TENDERUAR.

Kriteret:

Shihet shum qarte se AK ka pergatitje ku ulsëja ka dimenensione dhe pesh te caktuar pse duhet cekur Pesha, dhe standardi i nje kompani te caktuar. sipas nenit 28 duhet te jete eukovalente Neni 28 pika 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Autoriteti Kontraktues duhet te ju permbahet Standardeve te Kosoves siq thot neni 28 pika 4 . Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

Keto Standarde te Produkteve nuk jane te aplikushme ne vendin tone per arsyje se vendi jone nuk ka trup certifkues por keto certifikate blihen siq produkt jo qe tregon Cilsin e Produktit.

Ulsja eshte pika me diksriminuese ne kete dosje tenderit per arsyje se kjo eshte shum e kushtushme per tu sjell ne vend dhe shum qart shihet se kete lloj te fontanes e ka kompania SIQ SHIHET EDHE NE PROCESIN E HAPJES SE KETIJ TENDERI QE TANI ME ESHTE RI TENDERUAR.

Furnizimi, transproti dhe montimi i ulëses-sipas dimensioneve minimale:
L: 3300 mm
B: 500 mm
H: 450 mm
Pesha: 1000 kg
Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (Komuna e Gjakovës) nga materiali INOX.Përzierja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës(e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2). Derrasat e ulëses (7 copa) duhet te jenë sipas dimensioneve: L: 1900 mm B: 60 mm H: 40 mm. Dru i fortë i certifikuar nga FSC - bambu dhe me veshje të sipërme me ujë (llak) (ISO 9001)
Rrezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004)
Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019.
Hidroizolimi sipas standardit EN206:2013+A1:2016.
Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2013+A1:2016.Figura 2

Fontana eshte pika me diksriminuese ne kete dosje tenderit per arsyje se kjo eshte shum e kushtushme per tu sjell ne vend dhe shum qart shihet se kete lloj te fontanes e ka kompania SIQ SHIHET EDHE NE PROCESIN E HAPJES SE KETIJ TENDERI QE TANI ME ESHTE RI TENDERUAR.

Furnizimi, transproti dhe montimi i fontanës së ujit -sipas dimensioneve minimale:
L: 1100 mm
B: 430 mm
H: 900 mm
Pesha: 300 kg
Materiali nga betoni i kombinuar me mermer ose graniti (terrazzo), me sipërfaqe të lëmuar.Stampimi i llogos (Komuna e Gjakovës) nga materiali INOX.Përzierja e polirit zgjidhet nga organi mbikqyrës (e bardhë, kaft, hirit, e zezë etj).Me mbulesë Varnish-gloss spas standardit EN 1504-2).
Rrezistenca ndaj korezioni sipas standardeve (EN 13198:2003, EN ISO 15630-1- 2004, EN10025:2004)
Klasa e betonit C60/75 sipas standardit EN 12390-3:2019.
Hidroizolimi sipas standardit EN206:2021.
Rezistenca ndaj ngricave sipas standardit EN206:2021.Figura 3

Ne E morem si shembull ulësen kur e permendem me lart per arysje se ka shum produkte qe kan te njeja specifika me dimensione, pesha dhe standardi ju si Autoritet Konktraktues duhet te i eliminoni keto kushte ne dosjen e tenderit pasi qe jane favorizuese dhe shihet qart pas aplikim ne tender dhe procesit te hapjes

Kushtet dhe Kriteret e kontrates te prezantuar me lart jane Favorizuese dhe diskriminuese pasi qe na pamundeson pjesemarrjen ne kete tender per arsyje se kushtet e vendosuara nga AK Komun e Gjakoves jane te demshme dhe te kunderligjshme per favorizim te OE

Kerkesat mbi mundesin teknike dhe ose profesionale 9.1 dhe 9.2

Pika 2 Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet te dorëzoj mostrat për produktet e specifikuara në paramasë në pozicionet A (1, 2, 3, 4, 5, 6, 26, 65, 69, 91, 94, 193, 197). (këto produkte duhet ti ketë të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet)

keto mostra te cilat i kerkon AK eshte diskriminuese pasi qe keto produkte nuk prodhohen ne Vendin tone me kete teknik AK deshmon se ka favorizime per kete tender ku mostrat jane te madhesive te ndryshme duhet makineri e veqant per bartjen e tyre.

Neni 37.1 thot keshtu : Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u kërkohet të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni çertifkatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.

Pika 3 Produktet qe jane te kerkuar ne dosjen e tenderi nuk jane per mostra keto mund te behen me katalloge, mostrata kane shpenzime dhe demtojn OE.

Me qene Tenderi per produkte te mjekesi apo produkte qe kan ndikim drejt perdrejt ne jeten e qytetareve dhe paraqesin rrezik atehere ky term duhet te aplikohet per te sjell Mostra e jo Per Ulse, Llampa elektrike, shtylla te parkingjeve.

Autoriteti Kontraktues duhet qe ti heq keto kushte dhe kritere dhe te lejoj qe te marrin pjese te gjith OE e jo te pergatit Dosjen e Tenderit per nje OE te caktuar ku sipas kritereve thuajse e dim edhe OE se per ke eshte i pergatitur pasi qe kemi pare keto kushte dhe kritere te nje Autoritet Kontraktues tjeter.

Autoriteti Konktraktues duhet te veproj si pas Nenint 6 dhe nenit 7 dhe 28 te LPP-se ku me posht mund te gjeni keto:

Neni 6, i LPP-se përcakton:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7, i LPP-se, përcakton:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Neni 28, i LPP-se, përcakton:

1 Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.

1. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

2. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera.

3. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim.

4. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.

5. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

6. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

7. Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale.

8. Kur autoriteti kontraktues e ka parashtruar specifikimin teknik për kërkesat ekzekutuese ose funksionale, ai nuk mund të përdorë kërkesat e tilla si arsyetim për refuzimin e tenderit, produktit ose shërbimit që është në përputhshmëri me një specifikim të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni nëse specifikimi i tillë trajton kërkesat e njëjta ekzekutuese ose funksionale dhe është i përshtatshëm. Tenderuesi duhet të paraqesë në tenderin e tij, në mënyrën më të përshtatshme (siç është ajo e dosjeve teknike ose raportit të testimit nga një palë e tretë e pavarur), që produkti ose shërbimi, janë në përputhshmëri me specifikimet e lartpërmendura gjithashtu i plotëson kërkesat ekzekutuese ose funksionale të autoritetit kontraktues.

9. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Kerkojm nga AK Komuna e Gjakoves qe te bejm ndryshimin e kushteve dhe kriterev te dosjes se tenderit ku te na lejohet qe te jemi edhe ne pjesemarres pasi qe me keto kushte eshte e pamundur pasi qe ka bllokuar konkurencen dhe AK eshte ne kundershtim me nenin 28 LPP-se.

Kerkojm nga OSHP qe te thirre ne Seanc edhe Hartuesit e ketyre Specifikacioneve Teknike te ketij tenderi pasi qe si pas nje Organizate per Monotorim te Tendereve e cila eshte "Inciativa per progres – INPO" thot keshtu se shumica e specifikacioneve hartohen nga Operatoret Ekonomim te cilet edhe e fitojne Kontraten deshmi me posht gjeni edhe Hulumtimin e kesaj Organizate



Kerkojm nga OSHP qe te Kerkoj nga Komuna e Gjakoves qe te bej edhe ndryshimin e Paramases pasi qe paramasa eshte identike me nje AK tjeter, Asnje Autoritete Kontraktes nuk mund ti kete Kerkesat e njejta dhe secila duhet te jete e hartuar sipas nevojes se AK, gjitashtu tek paramasa shihet shume qart se ka gabime tek peshimi ku nuk eshte ndahur ne perqindje secila pjese por eshte lene hapsire per manovrime te cmimeve dhe me ate ne kuptojm se autoriteti Kontraktues mund te porosit nje produkt i cili ka cmimin me te larte per 70% te kontrates gjithashtu mund te ndodh edhe tek pjesa tjeter e cila eshte ndare me 30% te cmimit te peshuar.

Ne asnje pike te Paramases nuk eshte cekur fjala Ekuvalente (ose e ngjajshme) por edhe nese ceket kjo fjale nuk mund te behet pasi eshte permendur dimensionet te caktuar per produkte psh Fontana ka te cekur edhe peshen

Kerkojm nga Oshp-ja qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar ku te ndryshohen keto specifikacione Favorizuese te vendosura nga AK Komuna e Gjakoves.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDMI MBI RISHQYRTIM)

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.12.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
Pretendimi juaj se kërkesat e Autoritetit kontraktues për dimenzionet dhe peshën janë deskriminuese, është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues nuk ka vendosur limit fiks për këto kritere dhe është Autoriteti kontraktues ai që vendos kriteret dhe specifikat që mendon se janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të një aktiviteti.

Pretendimi juaj lidhur me mostrat është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues, ka vepruar konformë Nenit: 37, paragrafët 37.2 dhe 37.6, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022:

37.2 Kur kërkohen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve.

37.6 Mostrat e kërkuara janë pjesë e tenderëve, dhe ato janë pjesë të testit teknik të nevojshëm për vlerësimin e secilit tender. Si pasojë, testi bëhet pjesë e procesit të vlerësimit, dhe rrjedhimisht kontraktonin e përzgjedhur. Mostrat e kompanisë se shpërblyer me kontratë duhet të ruhen nga autoriteti kontraktues për gjatë tëre kohëzgjatjes se kontratës. Për sa i përket tenderuesve jo të suksesshëm, mostrat e tyre mund të kthehen tek ofertuesit (me kërkesë specifike) me kusht që ato ende ekzistojnë fizikisht (në kuptimin që testi nuk ka shkatërruar mostrën) dhe afati për të parashtruar ankese kundër vendimit të marrë nga autoriteti kontraktues për shpërblim të kontratës ka skaduar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Marisa SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 31/24 janë kundër specifikacionit Teknik për këtë aktivitet të prokurimit, ku sipas OE ankues AK në disa prej pozicioneve siq janë ulëset, fontata etj, ka kërkuar dimensioned he peshë specifike.

OE ankues pretendon se kjo është kërkesë diskriminuese qe favorizon një OE të caktuar.

Pas analizimit të dosjes së te tenderit, në veqanti paramasës, kemi gjetur se AK në shumë pozicione ka kërkuar dimensione specifike, mirëpo duke vendosur në fund të kërkesës dimensione "minimale".

Sipas mendimit të ekspertit shprehja "minimale" lenë mundësinë që OE-të të ofrojnë produkte me dimensione më të mëdha, mirëpo në këtë rast sipas mendimit tonë OE-të mund të ofrojnë produkte me dimensione dukshëm më të larta se ato të kërkuara e qka potencialisht mund të paraqes pengesa për realizim të mirë të prokurimit për AK-në, andaj vlerësojmë se për pozicionet siq janë ulëset, fontana etj, të caktohet një tolerancë e lejuar nga kërkesa e AK-së, psh toeranca +10%.

Ndërsa për pozicionet ku AK ka kërkuar peshë specifike/fikse, si psh ulëse me peshë 1000kg, apo fontana me peshë 300kg, [për mendimin tonë janë komplet të panevojshme, pasi pesha e fontanës dhe ulëses nuk është kurrfarë njësie matëse apo parametër I cili dëshmon kualitetin e produktit që ofrohet, dhe si e tillë kjo kërkesë konsiderojmë se duhet të hiqet në tërësi nga kërkesat e specifikaionit Teknik.

Bazuar në këto që u thanë më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Pretendimi nr.2

Pretendimi tjetër ankimorë është se AK për disa pozicione kërkesa për mostra është diskriminuese pasi kemi të bëjmë me produkte me pesha të renda (të cekura më lart) dhe tepër të kushtueshme për OE-të ofertues.

Pas analizimit të dosjes së tenderit, kemi gjetur se AK në dosje të tenderit ka këkruar :

"Operatori ekonomik së bashku me tenderin duhet te dorëzoj mostrat për produktet e specifikuara në paramasë në pozicionet A (1, 2, 3, 4, 5, 6, 26, 65, 69, 91, 94, 193, 197). (këto produkte duhet ti ketë

të gatshme për prezantim, në të kundërtën oferta do të refuzohet)."

Shumë prej këtyre pozicioneve kanë të bjënë me pesha të rënda, deri në 1000kg(sipas kërkesës së AK-së), andaj pajtohemi dhe ndajmë mendimin e njëjtë sikurse OE ankues që kjo është kërkesë e cila do të sillte shpenzime të larta dhe pa nevojshme për OE-të ofertues.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Pretendimi nr.3

OE ankes po ashtu pretendon se paramasa ka gabime dhe është paramasë e njëjtë me atë të një autoriteti kontraktues tjetër, dhe është e pamundutr që dy Autoritete kontraktuese ti kenë nevojat identike.

Megjithatë OE ankues nuk jep sqarime të mëtutjeshme se cilat janë ato gabime që sipas tij gjenden në paramasë, apo në çfarë mënyrë ato mund të rregullohen, andaj edhe nuk mund të japim përgjigje konkrete në këtë pretendim ankimorë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E GJAKOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Marisa SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Ilir Halili